



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 325, datë 14.06.2023**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, PERIUDHA E VLERËSIMIT VITI KALENDARIK 2022, PËR GJYQTARËT {...}, {...}, {...}, {...}, {...} DHE {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat a) dhe ë) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja dh), të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, pas verifikimit të tre/katër kritereve të kandidimit për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500, nr. 501, nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarët z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.
2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:
  - Për gjyqtarin z. {...}- Relator znj. Irena Plaku - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. {...}
  - Për gjyqtarin z. {...}- Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. {...}
  - Për gjyqtarin z. {...}- Relator znj. Irena Plaku - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. {...}

- Për gjyqtaren znj {...}- Relator znj. Yllka Rupa - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. {...}
- Për gjyqtaren znj. {...}- Relator znj. Yllka Rupa - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. {...}
- Për gjyqtaren znj. {...}- Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. {...}

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**